

NJOFTIM PER SHYTP

Autoriteti Portual Durres, Partner ne projektin ADB Multiplatform

Autoriteti Portual Durrës, që prej fillimit të vitit 2013 ka qënë pjesë e projektit ADB Multiplatform, duke marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e zhvilluara në kuadër të këtij projekti. Projekti synon të ndihmojë në përmirësimin e standarteve të transportit, të unifikojë modele për një zhvillim dhe menaxhim të qëndrueshëm të zinxhirëve logjistikë. Projekti kombinon këta faktorë të rëndësishëm për të ndihmuar në integrimin e vendeve të Europës Juglindore në ekonominë e përbashkët europiane.

Aktivitetet e ndërmarra gjatë implementimit të projektit kanë marrë në konsideratë rrjetet ekzistuese infrastrukturore dhe politikat në fushën e transportit.

Kështu, shumë nga aktivitetet e kryera kanë të bëjnë me vlerësimin e standarteve ekzistuese të transportit, analizën e problematikave, zhvillimin e korridoreve cilësore dhe Qëndrave të Zhvillimit Multimodal, hartimin e marrëveshjeve për një transport në respekt të mjedisit ndërmjet partnerëve të projektit si dhe module trainimi të përbashkëta.

Drejtimet në të cilat është fokusuar projekti janë:

- Përmirësimi i lidhjeve ndërmjet rajoneve të Adriatikut të sipërm dhe Austrisë/Slllovakisë/Slllovenisë/Kroacisë/Serbisë.
- Përmirësimi i lidhjeve ndërmjet Porteve të Egjeut me Bullgarinë, Ukrainën dhe vendet e Ballkanit përmes zhvillimit të rrjeteve hekurudhore.
- Përmirësimi i lidhjeve brenda Adriatikut.
- Përmirësimi i linjës hekurudhore që përshkon vendet nga Sllovakia në Turqi.

Gjatë implementimit të projektit, Autoriteti Portual Durrës ka marrë pjesë duke u siguruar partnerëve informacionin e nevojshëm për realizimin e përbashkët të aktiviteteve të projektit.

Kështu, APD ka kontribuar në:

- Krijimin e hartës së korridoreve si dhe të një guide për monitorimin e korridoreve dhe krijimin e një databaze për gjurmimin e ngarkesave. Kjo do të mundësojë



komunikimin online ndërmjet vendeve të përfshira, në lidhje me lëvizjen e ngarkesave në korridoret e Europës Juglindore.

- Monitorimin e cilësisë së korridoreve, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve ndërmjet vendeve partnere të projektit.
- Studimin e sistemit doganor në Shqipëri, fokusuar në sistemin elektronik që përdorin doganat shqiptare.
- Sigurimin e të dhënave të portit për hartimin e një Qendre Zhvillimi Multimodal, e cila po krijohet në Tiranë nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë. Kjo do të shërbejë operatorëve në fushën e transportit të kenë informacionin që ju duhet në lidhje me transportin në vendet e Europës Juglindore.
- Studimin e ndikimit në mjedis të mjeteve të transportit në korridoret e EJT dhe mënyrat e llogaritjes së kostove të eksternaliteteve. Për këtë, po përgatitet një Memorandum Bashkëpunimi ndërjet vendeve partnere të projektit, për aplikimin e mënyrave të njëjta të pagesave të kostove eksternale.
- Krijimin e databazës për monitorimin e ngarkesave në zonën pilot Durrës-Bar-Levante.

Takimi prezantues i projektit, u zhvillua në Trieste në 18.09.2012

Deri tani janë zhvilluar 7 takime të grupit drejtues të projektit, përkatësisht në: Budapest (20-22 Nëntor 2012), Beograd (29-31 Janar 2013), Konstanca (22-24 Maj 2013), Selanik (24-26 Shtator 2013), Sofje (28 – 30 Janar 2014), Tiranë (27-29 Maj 2014) dhe Budva (29-30 Shtator 2014). Në Nëntor 2013, u zhvillua në Bruksel, një Konferencë ku u trajtuan çështjet më të rëndësishme të projektit, arritjet dhe të rejtat që ky projekt sjell në fushën e transportit.

Konferenca finale e projektit është programuar të zhvillohet në Itali, në Nëntor 2014.

Si partnere e projektit ADB, Autoriteti Portual u përfaqësua në takimin vjetor të Programit Europa Juglindore (South East Europe – SEE), ku u diskutuan projektet e financuara nga ky program dhe fushat në të cilat do të fokusohet në të ardhmen. Takimi u zhvillua në Lubjana, Slloveni në datat 24-25 shtator 2014.

Per me teper: <http://www.adbmultiplatform.eu/adb/>



